



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 21 maj 2025

Z. Betim Sopi, kryetar, Këshilli Drejtues i ShFMU-së “Elena Gjika”
Rr. “Emin Duraku”, nr. 7
Komuna e Prishtinës
10 000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

R. nr. 924/2024

Lidhur me ligjshmërinë e marrëveshjes

I nderuari z. Sopi,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1¹, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 20 shtator 2024 pranoi ankesën e z. Behlul Zekës (ankuesi), parashtruar kundër ShFMU-së “Elena Gjika” (në tekstin e mëtejme: shkolla), lidhur me kontestimin e ligjshmërisë së dokumentit “Marrëveshja e shkollës me prindërit e klasës së parë dhe të gjashtë” (në tekstin e mëtejme: marrëveshja). Ankuesi theksoi se më 17 shtator 2024 shkolla ia dorëzoi marrëveshjen për nënshkrim, për të cilën shprehu vërejtjet e tij në lidhje me ligjshmërinë e saj. Sipas ankuesit, kjo marrëveshje zbatohet vetëm për nxënësit e klasës së parë dhe të gjashtë, nuk përmban asnjë detyrim për shkollën dhe nuk u nënshkrua nga përfaqësues të shkollës. Ai po ashtu pohoi se kjo shkaktoi konfuzion për shkak të përdorimit të termave “prindi 1” dhe “prindi 2” si nënshkrues të marrëveshjes, që është kundër ligjit, pasi sistemi juridik nuk e njeh konceptin “prindi 1” dhe “prindi 2”.

Më 17 janar 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kërkoi nga shkolla informacione në lidhje me veprimet që janë ndërmarrë ose që priten të ndërmerren në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësiave ligjore lidhur me çështjen. Po ashtu kërkoi që shkolla të përgjigjet në pyetjet e mëposhtme, në mënyrë që të sigurohen informacionet e nevojshme dhe pasqyra e qartë lidhur me çështjen: “1. A është propozuar/hartuar marrëveshja nga Këshilli Drejtues i SHFMU “Elena Gjika” (Këshilli), nëse po, na dërgoni aktin e propozimit/miratimit? 2. A ka hartuar Këshilli rregullat e shkollës sipas nenit 22 të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nëse po, na dërgoni aktin/et e miratuar/propozuar? 3. Na ofroni çdo informatë apo dokument tjetër relevant që konsideroni se mund të ndihmoj dhe plotësoj të dhënat për çështjen në fjalë.”

¹ Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat që pranon nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, me ligje dhe me akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

Më 30 janar 2025 përfaqësuesja e shkollës e informoi përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit: *“Sa i përket pyetjeve të parashtruara nga ana e Juaj, po ju dërgojmë dokumentet standardizuara të shpërndara nga DKA për të gjitha shkollat në Komunën e Prishtinës [...]”* Avokati i Popullit vlerëson se shkolla nuk ofroi përgjigje të plota për pyetjet e paraqitura. Megjithatë, kjo nuk e ndalon Avokatin e Popullit që t’i nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse lidhur me çështjen.²

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 16 Shtator 2011, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 04/L-032), rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 të ISCED-së, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.³ Sipas këtij ligji, Këshilli Drejtues është organi përgjegjës për qeverisjen e institucionit arsimor apo aftësues, duke kryer funksionet e parashikuara nga ky ligj. Për më tepër, ky ligj⁴, në nenin 17, ka përcaktuar përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes së Këshillit Drejtues: *“1. Çdo institucion publik arsimor dhe aftësues duhet të ketë këshillin drejtues. Në rast se këshilli drejtues nuk mund të formohet ose nuk mund të mbledhet në periudhën prej tre (3) muajsh, funksionet e tij merren nga drejtori i institucionit, me kusht që komuna (Ministria në rastet e institucioneve të nivelit 4 të ISCED-it) vazhdon me përpjekjet e mëtutjeshme për ta themeluar këtë këshill dhe për të mbajtur takimet e tij çdo tre (3) muaj. 2. Këshilli drejtues përbëhet nga: 2.1. tre (3) përfaqësues të prindërve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të komuniteteve jo shumicë në komunë nëse ka ndonjë nxënës nga ato komunitete në atë institucion; 2.2. dy (2) përfaqësues nga shoqëria (palë me interes të emëruara nga komuna); 2.3. tre (3) përfaqësues të mësimdhënësve 2.4. për shkollat e nivelit 2 dhe 3 të ISCED-it, një përfaqësues të nxënësve, i zgjedhur nga nxënësit që vijojnë shkollimin.”* Në rrethanat e përcaktuara me këtë nen, numri i anëtarëve në këtë këshill mund të rritet.

Ligjdhënësi me Ligjin nr. 04/L-032 i ka dhënë detyra dhe kompetenca Këshilli Drejtues të shkollës: *të hartojë rregullat e shkollës të specifikuara në nenin 22 të këtij ligji, për t’u miratuar nga komuna; të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësimdhënësve nga anëtarët e Këshillit Drejtues, që të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve në emërimin e drejtorit, zëvendës drejtorit dhe mësimdhënësve të shkollës; të ushtrojë funksionet e ndërlydhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës, përfshirë edhe skemën e delegimit mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës, siç është përcaktuar në këtë ligj; të vendosë për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë; të miratojë aktivitetet jashtë kurrikulare të shkollës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës; të vendosë për kodin e veshjes së punonjësve dhe nxënësve; të shpreh pikëpamjet e veta për çështjet që kanë të bëjnë me shkollën apo çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar; të miratojë listën e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera shkollore për t’u përdorë në shkollë në bazë të propozimeve të mësimdhënësve të shkollës, brenda kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; të kontribuojë në hartimin e planit zhvillimor të arsimit nga komuna në rastet, kur ka të bëjë me shkollën përkatëse; të ushtrojë funksionet e tjera që i janë deleguar nga komuna në pajtim me ligjin.*

² Ligji për Avokatin e Popullit, neni 24, paragrafi 4: *“Refuzimi apo dështimi për t’iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.”*

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

⁴ Ligji nr. 04/L-032, neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17.

Për më tepër, në zbatim të Ligjit nr. 04/L-032 është nxjerrë Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr.03/2016 Këshilli Drejtues i shkollës (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi nr. 03/2016), i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave për zgjedhjen, funksionimin dhe përbërjen e Këshillit Drejtues të shkollës.⁵ Ky Udhëzim gjithashtu përcakton rolin e Këshillit Drejtues në hartimin e rregullave të shkollës, në zgjedhjen e personelit arsimor, në menaxhimin financiar, në donacione dhe kontribute, në aktivitete jashtëkurrikulare dhe në vlerësimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare⁶, si dhe mandatin e anëtarëve të Këshillit Drejtues, shkarkimin dhe pushimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të shkollës.⁷ Më 26 janar 2016, Udhëzimi nr. 03/2016 u nënshkrua nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe hyri në fuqi shtatë ditë pas nënshkrimit. Ky udhëzim, në nenin 2, paragrafi 1, përcakton: “*Këshilli Drejtues i shkollës është organi më i lartë këshillëdhënës dhe vendimmarrës në shkollë.*” Sipas nenit 3 të këtij udhëzimi, Këshilli Drejtues përbëhet nga tre përfaqësues të prindërve⁸, dy përfaqësues nga shoqëria⁹ dhe tre përfaqësues të mësimdhënësve.¹⁰ Përfundimisht, ky numër mund të rritet në përputhje me rrethanat e përcaktuara në këtë Udhëzim. Sipas nenit 3, paragrafi 1.5: “*Drejtori i institucionit arsimor ushtron funksionin e sekretariatit të Këshillit Drejtues.*”

Avokati i popullit, pas vlerësimit të dokumentacionit të çështjes dhe instrumenteve përkatëse ligjore, vlerëson se marrëveshja në fjalë përmban dispozita të natyrës normative-juridike, të cilat nuk mund të konsiderohen si pjesë e një marrëveshjeje vullnetare, që varet nga pëlqimi apo refuzimi i prindit. Kjo nënkupton se, edhe në rast se prindi nuk e nënshkruan marrëveshjen, dispozitat që ajo përmban, përfshirë normat për regjistrimin e fëmijëve në institucionet arsimore, të drejtat dhe detyrat e nxënësve, Kodin e sjelljes për nxënësit, sanksionet për shkeljet e këtij kodit, çështjet që lidhen me gjësendet personale, masat për sigurinë etj., nuk mund të zbatohen. Në mënyrë të veçantë, pjesa e marrëveshjes që i referohet “Kodi i sjelljes për nxënësin” përmban 36 dispozita imperative, ndër to përfshin për shembull: Pika 23: “*Ndalohet të mbajë armë zjarri, armë të ftohtë ose gjësende të tjera të rrezikshme për jetën e nxënësve, personelit dhe të tjerëve.*” Pika 28: “*Nxënësi në asnjë rast nuk mund të pijë duhan në ambientet e shkollës dhe as gjatë aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga shkolla.*” Prandaj këto norma nuk janë të karakterit të një marrëveshjeje të bazuar në vullnetin e palëve, për faktin se ato nuk varen nga miratimi apo refuzimi i prindërve. Si pasojë, nëse marrëveshja nuk nënshkruhet nga prindërit, ato dispozita nuk mund të kenë efekte juridike.

Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se marrëveshja në fjalë përmban elemente të paqarta dhe konfuze, duke i munguar karakteristikat e një marrëveshjeje ligjore të plotë dhe për pasojë ajo nuk ka mbështetje të mjaftueshme ligjore ose në akte nënligjore. Në anën tjetër shkolla nuk ka mundur të vërtetonte se marrëveshja është hartuar, propozuar dhe miratuar nga Këshilli Drejtues, si dhe të vërtetonte se Këshilli Drejtues ka hartuar rregullat e shkollës sipas nenit 22 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, që do të thotë se në këtë rast Këshilli Drejtues i shkollës ka dështuar t’i zbatonte dispozitat e Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe të Udhëzimit Administrativ

⁵ Udhëzimi nr. 03/2016, neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.

⁶ Udhëzimi nr. 03/2016, neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.

⁷ Udhëzimi nr. 03/2016, neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3.

⁸ Të zgjedhur nga Këshilli i Prindërve i shkollës.

⁹ Emërohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit.

¹⁰ Të zgjedhur nga Këshilli i Mësimdhënësve.

(MASHT) nr. 03/2016, i cili përcakton funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Drejtues të shkollës.

Avokati i Popullit, pas vlerësimit të dispozitave përkatëse të lartcekura, thekson faktin se Këshilli Drejtues i shkollës është i detyruar, përveç të tjerash, t'i hartojë rregullat e shkollës, duke promovuar sjelljen e mirë dhe disiplinën e nxënësve, si dhe duke kontribuar në krijimin e një ambienti të shëndetshëm shkollor dhe eliminimin e dhunës.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla [...].”*

Prandaj Avokati i Popullit i


REKOMANDON

Këshillit Drejtues të shkollës ShFMU “Elena Gjika” në Prishtinë:

- *T'i hartojë rregullat e shkollës, në përputhje me dispozitat ligjore, duke promovuar sjelljen e mirë dhe disiplinën e nxënësve, si dhe duke e integruar konceptin e shkollave të shëndetshme. Këto rregulla të jenë të qarta dhe të zbatueshme për të gjitha palët e përfshira, duke marrë parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve, nxënësve dhe stafit shkollor.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”*), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerreni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naïm Qelaj

Avokat i Popullit